



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.11.2016
Referencë	11-344/10
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-TETOR



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin –TETOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranimet teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pelqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktivendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme e lokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra, plehra, pesticide si dhe tokav bujqësore	Mall me afat të skaduar	Biznese të pajisura teknike, per çmime
Biznesit	510	38	6	3		95			87			8	105	130						38
Ambientit	280	38		1		4			112					120			5			
Bujqësisë	172	14				23			46					64				25		
Ndërtimtarisë	152	25							104					23						
Trafikut	372	31				67	2	49		89	8			55			71			
Sanitar	161	29		2	34	18		21	14					21	22				57.53€	
Gjithsejtë	164	175	6	6	34	207	2	419	14	89	16	105	413	22	76	25	57.53€	38		

DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Gjatë muajit Tetor është punuar intensivisht rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjieno sanitare, kemi kontrolluar marketet ushqimore depot dhe bizneset të tjera rreth aftashmërisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mallë dhënie e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, krahasimin e çmimeve të produkteve të ekspozuara me ato të arkës, kalibrimin e peshoreve etj. Në agjendë gjatë tërë muajit ishte mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve.

Në përgjithësi gjatë tërë muajit tetor janë ngordhë 36 kafshë të cilat janë groposur në mënyrë profesionale në prezencë të Inspektorit Komunal.

Javën e fundit të këtij muaji nga AUV-i është marr vendim për shfuqizimin e vendimit për zbatimin e masave për Sëmundjen Gungore të Lëkurës (është bërë hapja e tregjeve të kafshëve). Në thertore kam inspektuar kafshët për therje ku gjatë muajit janë therrë 22 kafshë.

Gjatë këtij muaji është inspektuar në mbrojtjen e hapësirave publike dhe parqeve në qytet, duke dhënë vërejtje dhe urdhëresa me procesverbal për sanimin e gjendjes, dhe ndaj qytetarëve të cilët kanë lënë lëndë djegëse (dru) dhe mbetjet e tyre në hapësira publike t'i lirojnë ato dhe të bëjnë pastrimin e mbetjeve. Është dhënë vërejtje ndaj disa qytetarëve në f.sh Grackë e Vjetër për ndotje të ajrit për shkak të ndezjeve të gjetheve drunore. Gjithashtu ne fshatrat Gadime e Epërme, Medvec, Babushë i Muhagjerëve, Konjuhë dhe ne qytetin e Lipjanit është inspektuar në lidhje me problemet me ujërat e zeza, për çfarë janë urdhëruar me procesverbal qytetarët që të kyçen në rrjetin e kanalizimit. Është bashkëpunuar me Kompaninë Bechtel Enka për rrafshimin e materialit të dheut në hapësira publike në f.sh Konjuh, Babushë i Muhaxherëve të hedhur më parë nga kjo kompani. Ndaj një biznesi është bërë fletëparaqitje për shkak të mbulimit të pusëve dhe gropës septike me material nga dheu, dhe mos respektim të urdhëresës se dhënë.

Po ashtu gjatë këtij muaji janë bërë inspektime të vazhdueshme në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me Policin kufitare të Aeroportit në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marr masat ndëshkimore në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në rrugën "Lidhja e Prizrenit" ku janë inspektuar auto-taksit të cilët janë të vendosur në këtë rrugë .

Në bashkëpunim me Policin e Kosovës njësia në Lipjan janë bërë disa pika kontrolli ne qytetin e Lipjanit ku janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se a janë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për Licensë.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar tokat bujqësore ku i'u është ndërruar destinimi, ku nuk i'u është bërë shëndrrimi dhe tokat ku janë mbushur me dhe nga kompanitë e ndryshme.

Kemi pasur disa aksione mbi dëmtimin e tokave bujqësore në mënyrë të pakontrolluar nga mbushjet me materiale të ndryshme, kemi ndërpre disa vendpunime ku bëhej mbushja me material të ndryshëm të cilat nuk posedonin dokumente adekuate nga organi kompetent.

Kemi kontrolluar disa Barnatore Bujqësore mbi afatshmërin e Pesticideve si dhe posedimin e licensave adekuate mbi tregtimin dhe shitjen e Plehut dhe Farës sipas Ligjit për veprimtarin përkatëse.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar objektet në vendpunishte nëpër qytet si objekte me leje ndërtimore ku është përcjellë faza e punimeve ndërsa për objektet tjera janë marr masa konform ligjit të ndërtimit për ndalim të punimeve ilegale të cilat objekte janë duke u përcjellur vazhdimisht se mos po fillon ndonjë ndërtim pa leje ndërtimore.

Vlenë të cekët se inspektorët e ndërtimit jemi duke i kontrolluar të gjitha objektet ndërtimore (obj. afaristo-banesore) të cilat pasë kërkesës së investiorve për të kontrolluar çdo pozicion të ndërtimit pra nuk kryhet asnjë pozicion i betonimit pa e kryer inspektimin.